



**VENDIM**

**Nr. 111 Datë 04.11.2011**

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LIÇENSËS  
PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E  
CENTRALIT ELEKTRIK SI DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE ME SERI NPM06K, NR. 41, LESHUAR ME VENDIM TË  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.83, DT 27.11.2006 PËR  
SHOQËRINË ENERGO – SAS SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pika 2.3 e “Liçencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 15 pika 2 gërma “b”, dhe pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energo - SAS” sh.p.k për ndryshimin e liçencës Nr. 41, Seria NPM06K, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik si dhe prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 83, datë 27.11.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë "Energo - SAS" sh.p.k, plotëson kërkesat e “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”**: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçencës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”**: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçensë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçencës me Nr. 41, Seria NPM06K, të shoqërisë “Energo - SAS” sh.p.k, “Për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik si dhe prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 83, datë 27.11.2006.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**